



Bazuar ne Nenin 108/A te LPP 04/L-042 i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-68 dhe Ligjin 05/L-092, rregullores mbi Paraqitjen e Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, Zyra e Prokurimit, date 04.03.2020

merr këtë :

V E N D I M

PRANOHET, Kërkesa për Rishqyrtim e O.E "VALA" nga PRISHTINA, e bere me date 03.03.2020 permes EMAJLIT, Ku ka kërkuar qe TE ANULOHET Procedura e prokurimit nr. 634-20-526-221 me NR. INTERN 634-634-20-006-221 titull "SHERBIME TE TELEFONISE MOBILE PER NEVOJA TE ADMINISTRATES"

1.

Ankuesi VALA nga Prishtina, Pretendon dhe bazohet ne LPP "qe per Aktivitete qe ka nevojë për ndonjë Shërbim te Cilin e Posedon poashtu një Autoritet Publik ne Republikën e Kosovës, Ne rastin Konkret Telëzomi i Kosovës duhet te Veproje ne baze te paragrafit 4 te Nenit 9 te LPP"

2

Bazaar ne kete Perkohesisht SUSPENDOHET ky aktivitet dhe shikuar Interpretimin e KRPP.

3

A.K.Para fillimit te Ketij Aktiviteti ka kerkuar sqarimet e nevojeshme nga AQP (per Prokurimet e Centralizuara, qe kemi marr pergjigje se ky aktivitet nuk eshte ne Listen e procedurave te Centralizuara, dhe Ministria e Administrates Publike me Dy shkresa por Ky institucion nuk na eshte pergjigjur.

Keshilla Juridike

Kunder këtij vendimi O.E i pakënaqur me kete ka te drejt te parashtroj Ankes pran OSHP brenda afatit te përcaktuar me LPP Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Neni 109.

Zyra e Prokurimit

Z. Abaz Foniqi



Abaz Foniqi

From: Abaz Foniqi
Sent: Tuesday, March 03, 2020 1:08 PM
To: 'Bahri Prebreza'
Cc: Kreshnik Domi; Milaim Kryeziu; Enis Shala
Subject: RE: Kërkesë për Rishqyrtim

QESHTJE E JUAJA .

Me date 26.12..2018 Urdheresa-Njoftimi KRPP qe Specifikon nga data 01.01.2019 cdo procedure (perveq atyre me vlere minimale duhet te udhehiqen ne e- prokurimi , Ne kete Hyne edhe Kerkesa per Ri-Shqyrtim qe eshte Link te cdo procedure , Kjo eshte per ceshtje transparence .

Do merrni pergjigje ne afatin e lejuar nga Ligji I PP.

From: Bahri Prebreza [mailto:Bahri.Prebreza@kosovotelecom.com]
Sent: Tuesday, March 03, 2020 11:23 AM
To: Abaz Foniqi
Cc: Kreshnik Domi; Milaim Kryeziu; Enis Shala
Subject: RE: Kërkesë për Rishqyrtim

I nderuar,

Bazuar në njoftimet e ofruara tek webfaqja e KRPP-së, pjesa e Legjislacioni Sekondar, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ per Prokurimin Publik, lidhur me Ankesat (faqe 146) udhëzon palët që të ju referohen rregullave si mëposhtë:

60. Ankesat

Referoju rregullave te aprovuara nga KRPP, te publikuara ne webfaqen e KRPP-se, F03 "Rregullat për parashtrim te ankesave".

Bazuar në këtë konsiderojmë se Kërkesa për Rishqyrtim e dërguar me e-mail nga Telekom i Kosovës është në përputhje me rregullativen ligjore në fuqi.

Përsëndetje - Best Regards,

Bahri Prebreza
Kordinator i Shitjes Teknike
Departamenti i Shitjes



Telekomi i Kosovës Sh.A.
Kosovo Telecom J.S.C.

Tel: + 383 (0) 38 223 383
Mob: + 383 (0) 44 405 406

Fax:
bahri.prebreza@kosovotelecom.com
www.kosovotelecom.com

Important: This e-mail and any attachment(s) are intended for the addressees above named only and may be confidential. If you are not an addressee please notify me immediately. You must not copy or disclose the contents to any third party. Internet e-mail is not a fully secure communications medium. Please take this into account when sending e-mail to me. Any attachment(s) to this e-mail are believed to be free from virus, but it is the responsibility of the recipient to make all the necessary virus checks.
P *Help save trees - do you need to print this email?*

From: Abaz Foniqi [mailto:Abaz.Foniqi@rks-gov.net]

Sent: Tuesday, March 03, 2020 10:24 AM

To: Bahri Prebreza <Bahri.Prebreza@kosovotelecom.com>

Cc: Kreshnik Domi <Kreshnik.Domi@kosovotelecom.com>; Milaim Kryeziu <Milaim.Kryeziu@kosovotelecom.com>; Enis Shala <Enis.Shala@kosovotelecom.com>

Subject: RE: Kërkesë për Rishqyrtim

Konfirmim i panimit te kerkeses .

Megjithate duhet ta postoni edhe ne e- prokurimi .

Me respect

From: Bahri Prebreza [mailto:Bahri.Prebreza@kosovotelecom.com]

Sent: Tuesday, March 03, 2020 10:19 AM

To: Abaz Foniqi

Cc: Kreshnik Domi; Milaim Kryeziu; Enis Shala

Subject: Kërkesë për Rishqyrtim

I nderuar,

Të bashkangjitur gjeni Kërkesën për Rishqyrtim të aktivitetit të prokurimit: 634-20-526-2-2-1, sa i përket Njoftimit për Kontratë për: " SHERBIME TELEFONISE MOBILE PER NEVOJA TE ADMINISTRATES KOMUNALE".

Gjithashtu, të bashkangjitur e keni edhe përgjigjen e dhënë - interpretimin ligjor të bërë nga KRPP-ja të Paragrafit 4 të Nenit 9 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) me kërkesë të Telekomit të Kosovës, në të cilin në mënyrë specifike sqarohet se:

- Çdo Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) në Republikën e Kosovës, i cili ka nevojë për ndonjë shërbim të cilin e posedon po ashtu një Autoritet tjetër Publik në Republikën e Kosovës (në rastin konkret Telekomit i Kosovës) duhet të veprojë në bazë paragrafit 4 të nenit 9 të këtij ligji (shih dokumentin).

Ju lutem na konfirmoni pranimin e këtij e-maili.

Përshëndetje - Best Regards,

Bahri Prebreza

Kordinator i Shitjes Teknike

Departamenti i Shitjes



Telekomi i Kosovës Sh.A.
Kosovo Telecom J.S.C.

Tel: + 383 (0) 38 223 383

Mob: + 383 (0) 44 405 406

Fax:

bahri.prebreza@kosovotelecom.com

www.kosovotelecom.com

Important: This e-mail and any attachment(s) are intended for the addressees above named only and may be confidential. If you are not an addressee please notify me immediately. You must not copy or disclose the contents to any third party. Internet e-mail is not a fully secure communications medium. Please take this into account when sending e-mail to me. Any attachment(s) to this e-mail are believed to be free from virus, but it is the responsibility of the recipient to make all the necessary virus checks.

P Help save trees - do you need to print this email?

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI KOMUNAL I KLINËS

Për Aktivitetin e Prokurimit: 634-20-526-2-2-1

Sa i përket tenderit për: SHERBIME TELEFONISE MOBILE PER NEVOJA TE ADMINISTRATES KOMUNALE

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

TELEKOMI I KOSOVËS Sh. A.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

DARDANIA 10000 PRISHTINE, REPUBLIKA E KOSOVËS

(Adresa)

PRISHTINË

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344477433

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Kreshnik Domi


(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

kreshnik.domi@kosovotelecom.com

(Adresa elektronike)

03.03.2020

(Data e parashtrimit të kërkesës)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefoni)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]

Me datën 28.02.2020 KUVENDI KOMUNAL I KLINËS në Njoftim për kontratë ka shpallë tender për: "SHERBIME TELEFONISE MOBILE PER NEVOJA TE ADMINISTRATES KOMUNALE"

Procedura e aplikuar sipas KUVENDI KOMUNAL I KLINËS për këtë aktivitet të prokurimit është :
Procedurë e Hapur

Lloji i kontratës është: Kontrate publike kornizë me një operator

Afati i fundit për dorëzim të ofertave është parapare me datën 20.03.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 9.4 – Përcaktimi i nevojave që duhet të Përmbushën (Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS)

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshtetja rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

- Neni 9.4 – Përcaktimi i nevojave që duhet të Përmbushën

Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim: “autoriteti kontraktues kur është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t’u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”. Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik, për më tepër edhe interpretimi i KRPP-se thekson se një autoritet kontraktues publik nuk ka nevojë të procedoj ndonjë procedurë të prokurimit përderisa një shërbim ofrohet nga një autoritet tjetër kontraktues publik. Shih citatin e KRPP-së:

Citati:

36. Duke marr për bazë dilemat e shfaqura të Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta të tyre (drejtuar KRPP-ës) që të bëhet e qartë se si duhet të veprohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevoj për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik?

Konform neni 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim:

Sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik".

Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevoj për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik.

LPP, nuk e sqaron më tej se si autoritet publike do të rregullojnë plotësimin e nevojave të tyre (ne mes vete) meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.

Mirëpo është mëse e qartë se këto raste kanë të bëjë me **përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik** kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tij ose shërbimeve të një autoriteti tjetër kontraktues pa inicuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim "në shtëpi").

Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-es, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 të LPP-së

LINKU: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=NewsPub&LID=1&PCID=1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCNews&ID=313>

PROPOZIMI I TELEKOMIT TË KOSOVËS

Të anulohet Njoftimi për kontratë nga KUVENDI KOMUNAL I KLINËS dhe të fillohet një procedure e re në përputhje me interpretimin e KRPP-se dhe në kërkesat e neni 9.4 të LPP-se.

Dmth KUVENDI KOMUNAL I KLINËS nuk ka nevojë të përdor procedurë të prokurimit, pasi që shërbimet në fjalë ofrohen nga një institucion publik që përdor fonde publike.

Mënyra proceduese e anulimit është: KUVENDI KOMUNAL I KLINËS duhet të kërkojë nga KRPP ose autorizim që të bëjë anulimin e Njoftimit për kontratë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që mund të shkaktohen nga mos përdorimi i LPP-se nga ana e KUVENDI KOMUNAL I KLINËS janë shume të mëdha dhe në vlerë monetare ato mund të shkojnë me mijëra euro, përafërsisht 36.000,00 euro për 36 muaj.

Këto dëme ne mënyrë te drejtpërdrejtë dëmtojnë BUXHETIN e KOSOVES pasi që TELEKOMI I KOSOVES është ndërmarrje publike dhe siç e ka përcaktuar KRPP konsiderohet **blerje në SHTËPI**.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



Për :	z. Agron S. Mustafa- Drejtor Menaxhues Telekomi i Kosovës SH.A	Kopja:	Arkivi i KRPP- së
Përmes:	Safet Hoxha – Kryetar i KRPP-ës		
Nga :	Sami Uka – Kryesues, D. i Rregullave Floride Salihi – Zyrtare Ligjore, D. i Rregullave		
Lënda:	Përgjigjeje e kërkesës me nr. 171/2016 të datës 14.10.2016		
Datë:	03.11.2016		

I nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në të dhënat e shkresës suaj, KRPP iu ofron interpretimin ligjor si në vijim:

Paragrafi 4 i nenit 9 të këtij ligji sa i përket çështjes se si duhet të vepohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevojë për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik përcakton si në vijim:

“Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t’u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”

Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoritet Publik), ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik (në rastin konkret **Telekomi i Kosovës**).

LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do të rregullojnë plotësimin e nevojave të tyre (në mes vete) meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera. Mirëpo është mëse e qartë se këto raste kanë të bëjnë me përfundimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik.

Si përfundim KRPP konsideron se çdo Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) në Republikën e Kosovës i cili ka nevojë për ndonjë shërbim të cilin e posedon po ashtu një Autoritet tjetër Publik në Republikën e Kosovës duhet të veprojë në bazë të paragrafit 4 të nenit 9 të këtij ligji.

KRPP, gjithashtu i'u informon se interpretimin e paragrafit 4 të nenit 9 (të cilin do ja bashkëngjisim edhe kësaj shkrese) e ka publikuar në ueb-faqen e KRPP-ës, përkatësisht interpretimi i tillë është i publikuar në linkun “ndihmesë”- “pyetjet e shpeshta” përgjigjja me Nr.36.

Me respekt.

36. Duke marr për bazë dilemat e shfaqura të Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta të tyre (drejtuar KRPP-ës) që të bëhet e qartë se si duhet të veprohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevoj për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik?

Konform neni 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim:

Sa i përket qështjës së parashtruar më lartë, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik".

Pra neni i lartëcituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevoj për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik.

LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do të rregullojnë plotësimin e nevojave të tyre (ne mes vete) meqë kjo është qështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.

Mirëpo është mëse e qartë se këto raste kanë të bëjnë me **përfjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik** kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tij ose shërbimeve të një autoriteti tjetër kontraktues pa inicuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim "në shtëpi").

Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-së, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë qështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 të LPP-së